

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 4485 REP.
NR. 1616 KOL.



KONTRATË DHURIMI
(Kuotash Kapitali)

Sot më datë 08.09.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), para meje noteres publike, H. Dllasli anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur në S. Delving, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate dhurimi në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), statutit të shoqërisë “SIGI” SHPK dhe vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë të datës 16.09.2019, me kushtet e mëposhtme:

I PALËT

Pala Dhuruese:

Juliana Xhabafti, e bija e Besnikut dhe e Fatimes, e datëlindjes 05.05.1975, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, rruga “Perlat Rexhepi”, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit numër 024658703 dhe numër personal H55505269E, lëshuar nga Ministria e Brendshme e shtetit shqiptar më datë 25.03.2009 dhe e vlefshme deri në datë 24.03.2019 (sipas VKM e vlefshme deri në datën 31.12.2019), e cila në këtë kontratë paraqitet në cilësinë e ortakut të shoqërisë “SIGI” SHPK

Pala pranuese e Dhurimit:

1) **Sokol Xhabafti**, shtetas shqiptar, i biri i Isait dhe i Naxhijes, i datëlindjes 03.01.1969, lindur dhe banues në Tiranë, rruga “Perlat Rexhepi”, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit numër 033969717 dhe numër personal G90103126I, lëshuar nga Ministria e Brendshme e shtetit shqiptar më datë 20.02.2019 dhe e vlefshme deri në datë 19.02.2029.

2) **Arta Dizdari**, e bija e Isait dhe e Naxhijes, e datëlindjes 10.11.1961, lindur dhe banuese në Tiranë rruga “Reshit Collaku”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit numër 030890007 dhe numër personal G16110193D, lëshuar nga Ministria e Brendshme e shtetit shqiptar më datë 04.04.2011 dhe e vlefshme deri në datë 03.04.2021.

Asho Bizeni

[Signature]

[Signature]



Kushtet Paraprake

- Shoqëria "SIGI" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), më datë 08.09.2004, me Certifikatë Regjistrimit NUIS (NIPT) K42201008B, me zyrë qendrore në Tiranë, fshati Picar, godinë 4 katëshe, përballë xhamisë së fshatit, Vorë, me kapital të regjistruar 204,000,000 (dyqind e katër milion) lekë, me ortak z. Sokol Xhabafti, zotërues i 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe znj. Juliana Xhabafti, zotëruese e 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë; me administrator z. Sokol Xhabafti;
- Ortaku Juliana Xhabafti ka shprehur vullnetin e saj në vendimin e datës 16.09.2019 që një pjesë të kuotës që ajo zotëron në shoqërinë "SIGI" SHPK, kuotë e cila përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë t'ia kalojë një pjesë e cila përfaqëson 10% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ortakut Sokol Xhabafti dhe një pjesë e cila përfaqëson 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë znj. Arta Dizdari dhe në bazë të këtij vendimi lidhet kjo kontratë dhurimi;
- Kuota është e lirë nga çdo barrë, siç vërtetohet dhe vërtetimi i sjellë nga Regjistri i Barrëve Siguruese më datë 17.09.2019.

II OBJEKTI

Nëpërmjet kësaj kontrate dhuruesi ortakut Juliana Xhabafti një pjesë të kuotës që ajo zotëron në shoqërinë "SIGI" SHPK, e cila përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, do t'ia dhurojë ortakut Sokol Xhabafti dhe znj. Arta Dizdari, në përqindjet si më poshtë:

- Ortakut Sokol Xhabafti i transferohet pjesa e kuotës e cila përfaqëson 10% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "SIGI" SHPK;
- Znj. Arta Dizdari i transferohet pjesa e kuotës e cila përfaqëson 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "SIGI" SHPK.

Dhuruesi deklaron se kuotat janë të lira dhe mbi to nuk ka të vendosur ndonjë barrë siguruese.

III PRANUESI I DHURIMIT

Pranuesit e dhurimit ortakut Sokol Xhabafti dhe znj. Arta Dizdari deklarojnë se e pranojnë dhurimin e bërë nga ortakut Juliana Xhabafti, për pjesët e kuotës së dhuruar objekt i kësaj kontrate.

IV KALIMI I PRONËSISË

Pronësia mbi pjesët e kuotës së kapitalit të regjistruar të shoqërisë "SIGI" SHPK, do të kalojë nga pala dhuruese Juliana Xhabafti tek pala pranuese e dhurimit Sokol Xhabafti dhe Arta Dizdari pas depozitimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë.

Pas depozitimit të kësaj kontrate ortakët e shoqërisë dhe pjesët e tyre takuese në shoqëri, do të jenë si më poshtë:

- Ortaku Sokol Xhabafti, do të zotërojë një kuotë e cila përfaqëson 60% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "SIGI" SHPK;

Arta Dizdari

Sokol Xhabafti

Juliana Xhabafti

- Ortaku Juliana Xhabafti, do të zotërojë një kuotë e cila përfaqëson 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "SIGI" SHPK;
- Ortaku Arta Dizdari, do të zotërojë një kuotë e cila përfaqëson 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "SIGI" SHPK.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën e noterit, një origjinal i cili regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB depozitohet në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noterja, ata më deklaruan se përmbajtja e kësaj kontrate është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noterja e vërtetoj atë në bazë të ligjit.


DHURUESI

JULIANA XHABAFTI




PRANUESI I DHURIMIT

SOKOL XHABAFTI



ARTA DIZDARI



< NOTERE

